6.1 6.1. *Sic jemi shprehur me lart nje pjese e ketyre rekomanimeve jane marre ne konsiderate dhe sitemuar, ne lidhje me zbatimin e rekomanimit nr 1 sqarojme se do te reflektohet nga drejtuesit EMP ne fazen e dyte te buxhetit afat-mesem 2024-2026.*

Hartoi : Emanuela Çekrezi

MIRATOI:  
GRUPI I MENAXHIMIT STRATEGJIK

Bajram Pishkashi

Ermir Sulollari

Elvira Poçi


Afërdita Alla


Lindita Shuli



Brixhilda Biçaku

Hysni Hoxha

Aleksander Brazhda

Erdis Alikaj



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA LIBRAZHD**  
**DREJTORIA E TË ARDHURAVE VENDORE**  
**Sektori i Transportit dhe Parkingut**

**P/V E N D I M**

NR \_\_\_\_\_ DATË \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_ 2023

**“PËR SHTESË ORARI NË LINJËN E TRANSPORTIT RRETHQYTETAS “**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “ Për Vetë Qeverisjen Vendore” dhe Ligjit nr. 8308 , datë 18.03.1998 “ Për transportet rrugore ” i ndryshuar, “ neni15 ” , pika “ ç ” me ligjin 10/2016 , “Udhëzimi nr.5627 ,datë 18.12.2016 “ Për përcaktimin e kriterieve për transportin rrugor të udhëtarëve ” , kërkesat e vazhdueshme të subjekteve dhe udhëtarëve , shkresës me nr .4596 prot ,date, 04.07.2023 ,pasi mori në shqyrtim, me propozim te Kryetarit të Bashkise, Këshilli Bashkiak i mbledhur sot më datë \_\_\_/\_\_\_/2023

**V E N D O S I:**

- 1- Shtimin e orareve në linjët rrëthqytetase ,Dragostunjë - Librazhd - Dragostunjë , tabela Nr. 2.2 me nr. kodi. 9.A  
Nisja : 07.30,08.45,13.30,16.00  
Kthimi : 08.00,12.15,14.15,17.00  
( sipas tabelës nr. 2.2 bashkëlidhur).
- 2- Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Sektori i Transportit e Pakingut ,Drejtoria e Ardhurave Vendore.
- 3- Ky urdhër hyn në fuqi mbas 10 ditësh nga dalja e Vendimit të Këshillit Bashkiak.

**KRYETARI I BASHKISE**  
**Mariglen Disha**





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA LIBRAZHD  
DREJTORIA E TË ARDHURAVE VENDORE

*Librazhd më, 14.07.2023*

**RELACION  
“PËR SHTESË ORARI NË LINJËN E TRANSPORTIT RRETHQYTETAS“**

**Tënderuar Këshilltare!**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “ Për Vetë Qeverisjen Vendore” dhe Ligjin, nr. 8308 , datë 18.03.1998 “ Për transportet rrugore “i ndryshuar, “ nen 15 ” , pika “ ç ” me ligjin 10/2016 , “Udhëzimi nr .5627, datë 18.12.2016 “ Për përcaktimin e kriterieve për transportin rrugor të udhëtarëve “, shkresës me nr .4596. Prot, datë 04.07.2023 , kërkesave të udhëtarëve pranë Sektorit të Transportit, Drejtoria e të Ardhurave Vendore, kërkojmë që të miratohet shtesë orari në linjën e rregullt rrethqytetase Dragostunjë -Librazhd dhe anasjelltas , pasi linja e specializuar nuk eshte ne ndihme te udhetareve dhe kërkesat kanë qënë të vazhdueshme .

Ka patur probleme ne transprtin e udhetareve dhe mos funksionim e mire te linjes se transportit . Gjithashtu është i domosdoshëm për të ndihmuar e lehtësuar transportin e udhëtarëve në atë zonë të fshatit Dragostunje .

Sa më lart kërkojmë që të miratohen oraret sipas Projekt- Vendimit.

Ju faleminderit !

**DREJTORE E TË ARDHURAVE VENDORE  
Lindita SHULI**



**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA LIBRAZHD**

**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT, SHERBIMEVE DHE STREHIMIT.**

**PROJEKT VENDIM  
Nr. datë . .2023**

**“ PËR MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I SUBVENCIONIMIT TË INTERESAVE TË KREDISË ME KUSHTE LEHTËSUESE NGA SHTETI”**

Duke u mbështetur në Ligjin Nr 22/2018 “Për Strehimin Social”, Ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 8 pika 2 dhe neni 9 pika 1.1 b dhe neni 24 pika 2, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.384 datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim, sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetqeverisjes vendore” dhe VKM Nr. 453 datë 03.07.2019 ”Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe proceduren e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuar nga shteti”, i ndryshuar me VKM Nr. 268 datë 29.04.2022, Kryetari i Bashkisë me propozim të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit:

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë listën sipas pikëzimit për 1 familje që do të përfitojnë nga programi i subvencionimit të interesave të kredisë me kushte lehtësuese nga shteti sipas tabelës Nr.2 bashkëlidhur këtij projektvendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikim dhe Zhvillim Territorit, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Sektori Juridik.
3. Vendimi hyn në fuqi pas shprehjes së ligjshmërisë nga Prefektuara, dhe në përputhje të nenit 55, pika 6, të ligjit 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

**KRYETARI BASHKISE  
MARIGLEN DISHA**



---

REPUBLIKA E SHQIPERISË

BASHKIA LIBRAZHD

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT, SHERBIMEVE DHE  
STREHIMIT.

**RELACION  
Mbi Projekt-Vendimin**

Me objekt : “Miratimin e listës së familjeve që do të përfitojnë nga programi i subvencionimit të interesave të kredisë me kushte lehtësuese nga shteti”

Duke u mbështetur në Ligjin Nr 22/2018 “Për Strehimin Social”, Ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 8 pika 2 dhe neni 9 pika 1.1 b dhe neni 24 pika 2 , si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.384 datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim, sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të proçedurave të miratimit nga organet e vetqeverisjes vendore”

Hartimi dhe përzgjedhja nga Komisini I Strehimit i listës përfituese është bërë në bazë të ligjit nr 22/2018 “Për Strehimin Social”, VKM-së Nr.453, datë 03.07.2019 “Për masën e subvencionimit të interesave të kredisë dhe proçedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuar nga shteti”, ku lista përfituese miratohet sipas sistemit të pikëzimit dhe që plotësojnë kushtet:

a) Kanë të ardhura mujore jo më të larta se të ardhurat mesatare të njësisë së vetqeverisjes vendore përkatëse dhe nuk përballojnë dot pagesat e kredisë për blerjen e një banese me vlerë jo më të madhë se mesatarja e vlerave të tregut në atë njësi dhe me sipërfaqe jo më të madhe se normat e strehimit.

b) Nuk disponojnë banesë në pronësi ose disponojnë pronësi nën normat e strehimit, apo janë zhvendosur nga banesat sipas parashikimeve të nenit 6, të ligjit nr.22/2018.

Shkresës nr.18627 prot. datë 17.10.2019 “Mbi projektin e subvencionimit të interesave të kredisë” nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ku përparsi në përzgjedhjen e përfituesve kanë -çiftet e reja dhe të rinj deri në moshë 35 vjec, -familje të komunitetit Rom dhe Egjiptian, -gra kryefamiljare/gra të dhunuara , por pa u kufizuar në to si dhe sipas sistemit të pikëzimit miratuar me VKB Librazhd Nr.5, datë 31.01.2023.

*Konc. Ani Tetë*  
*[Signature]*

## **Relacion mbi familjet e propozuar për miratim.**

### **A)Lista**

- 1. Bledar Mojsja.** Familje e përbërë nga 4 antarë. Nuk disponojnë banesë në pronësi jetojnë me qira. Vetëm një antarë i punësuar me të ardhura të ulta nën 70% të të ardhurave mesatare.

## Lista parësore me familjet e kualifikuara për programin e subvencionimit të interesave të kredisë.

Nr. Rendor	Emri/Aftësia/Mbiemri	Përberj a familja	Struktura apartamente përfiton	Kushtet e strehimit (neni 16, gjermania(a) e njit që përfiton	Kushtet e strehimit (neni 16, gjermania(b) e njit që përfiton	Kushtet sociale (neni 16, gjermania(c) e njit që përfiton	Të ardhurat mujore neto të familjes	Punësimi	Kufiri maksimal i kredisë që përfiton familja	Numri i kontaktit
1	Bledar Hamit Mojsja	4	2+1	"1"	-	-	44,000	privat	3,080,000	0694776496

Komisioni i strehimit:

Marsida Muca

Ani Teta

Bajram Pishkashi



**KRYETARI I BASHKISË**

Mariglen Disha



**DREJTORIA E TE ARDHURAVE VENDORE**  
**Sektori i transportit**

Oraret e linjës kryesore rrethqytetase Bashkia Librazhd

**Data ,14.07.2023**

**TABELA Nr 2.2**

<b>Nr kodit</b>	<b>Linjat Kryesore</b>	<b>Nisja</b>	<b>Kthimi</b>	<b>Nr i orareve</b>
9.	A	Dragostunjë - Librazhd - Dragostunjë	07.30,08.45,13.30,16.00 08.00,12.15,14.15, 17.00	4 orare

Të poliqsim e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LIBRAZHD

KRYETARI

P/VENDIM  
NR \_\_\_\_\_ DATE \_\_\_\_/07/2023

“Mbi përdorimin e fondit të Emergjencave Civile”

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 Datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” nen 54 pika dh ,të Ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, të Ligjit Nr.9936 Datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe në Ligjin Nr.115/2021“Për Buxhetin e viti 2022”, në Udhëzimin Nr.2 Datë 6.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, udhezimin nr. 9 date 20.03.2018 “ Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit” ,Udhezimi plotesues nr.2 date 19.01.2023 “Per zbatimin e buxhetit te viti 2023”, VKM nr.414 datë 08.07.2021 “Miratimin e procedurave dhe kriterieve te ndarjes dhe te perdonimit te fondit te kushteza të buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile”,VKB nr. 107,datë 28.12.2022 “ Për miratimin e Buxhetit të viti 2023 të Bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesëm 2023-2025” ,“Këshilli i Bashkisë i mbledhur sot më datë \_\_\_\_/05/2023 me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

VENDOSI:

1. Të miratojë përdorimin e fondit në vleren 1,323,325 lekë emergjenc civile z.Sami Çota ,fshati Kokrevë ,Nj.Adm Hotolisht Bashkia Librazhd fatkeqsi natyrore(rënie zjarri në banesë).
2. Fondi prej 1,323,325 lekë do të përballohet nga fondi i Emergjence Civile buxheti i shtetit ne stukturen buxhetore si me poshtë:  

Grupi	titulli	kapitull	artikull	vlera
17	10910	0 1	604	1,323,325 leke
3. Ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Sektori Financës, Emergjencia Civile.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes .

Konc:

Miratoi:

KRYETARI I BASHKISË

MARIGLEN DISHA



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LIBRAZHD  
SEKTORI I MBROJTJES CIVILE

Librazhd më 25/7/2023

**RELACION**

*Për akordimin e ndihmës financiare për familjen e shtetasit Sami ÇOTA banesa e te cilit eshte demtuar nga fatkeqesi natyrore (renie zjarri)*

Në mbështetje të Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; ligjit Nr. 45/2019 datë 18.07.2019 “Për Mbrotjen Civile,” , VKM-së Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerezore”

1 Për familjen e shtetasit **Sami ÇOTA** banore i fshatit **Kokreve, NJ. A. Hotolisht**, Bashkia Librazhd. Në objektin (shtëpi banimi) për shkak të një shkëndije elektrike në rrjetin elektrik të brendshëm të ndërtuesës është shkaktuar rënie zjarri, duke djegur plotësisht banesën e ketij shtetasi se bashku me të gjitha pajisjet dhe orënditë shtëpiake. Ngjarje kjo e ndodhur me **dt 11.07.2023 ora 14.30** Për këtë familje, banesa e te cilit është dëmtuar nga fatkeqësi natyrore (**renie zjarri**) është përgatitur dokumentacioni tekniko – ligjor nga specialistet e Bashkisë Librazhd.

2.Familja e Z: **Sami ÇOTA** përbëhet nga 2 (dy ) persona.

3 Ne çertificate pronesie kjo banese rezulton me bashke pronare (**Sami Çota dhe Isa Çota**) me nr pasurie **59/10**

4. Ndhima financiare do të jepet bazuar në VKM - në nr. 329 datë 16.05.2012 Kreu i III/3/b/d Vlera financiare e dëmit të shkaktuara nga djegia e banesës eshte : **2.317.650 leke**.

**(Pa TVSH 20% pra vetem shuma 1 + shuma 2 ne Preventiv)**

Vlera financiare e mobiljeve,orendive dhe paisjeve elektro-shtëpiake eshte :**164 500leke**

**Perfitimi i ndihmes financiare llogaritet : 50% e vleres se demit ne banese pra 2.317.650 :2  
=1.158.825 shto vleren e demit ne orendi e mobilje (164 500 ) = 1.323.325leke**

**Shuma totale e ndihmes financiare qe duhet te perfitoje familja e Z: Sami Çota nga  
fatkeqesia natyrore (*renie zjarri ne banese* ) eshte 1.323.325 leke .**

**PËGJEGJËSI I SEKTORIT PËR MBROJTJEN CIVILE**

**Musa SHALLA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LIBRAZHD

Të ndryshme  
B  
P/VENDIM

Nr \_\_\_\_\_ Datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ 2023

**“PËR MIRATIMIN E PIKAVE TË MARRJES SË INERTEVE”**  
**PËR NEVOJAT E BASHKISË LIBRAZHD DHE KOMUNITETIT**

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 23 ,të ligjit 57/2020 datë 30.04.2020 “Për pyjet” , neni 26 , Vendimin nr. 433, datë 8.6.2016 për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-kunave/ bashkive” i ndryshuar, kërkesës së bërtë nga Drejtoria e Mirëmbatjes së Rrugëve Rurale , pasi dëgjoi përfaqësuesit e bashkisë :

VENDOSI:

1. Të miratojë me shkrim vazhdimin e procedurave për miratimin e pikave të marrjes së inerteve për nevojat e bashkisë Librazhd dhe komunitetit si më poshtë :
  - a. **Në Njësinë Administrative Qendër**  
Kthesa e Zenelit,fshati Dorëz  
Lugjet e Hysës,fshati Librazhd Katund  
Kodra e Aliajt ,fshati Kuturman  
Kthesa e Murrashit ,fshati Arrëz
  - b. **Njësia Administrative Orenjë**  
Përroi Galonit,fshati Floq  
Guri Lushit,fshati Orenjë  
Zabeli Suljet,fshati Orenjë  
Shkëmbi Lukës,fshati Funarës
  - c. **Njësia Administrative Hotolisht**  
Kodra e lagjes Çekrezi,fshati Dardhë  
Kodra e lagjes Kala,fshati Vulcan  
Bregu lagjes Kaminë,fshati Xhyrë
  - d. **Njësia Administrative Lunik**  
Fusha Nërvic ,fshati Lunik  
Maja e Peshkut,fshati Letëm  
Përroi i Zikës, fshati Prevallë
  - e. **Njësia Administrative Polis**  
Përroi i Shëllirës, fshati Polis Qendër  
Fushë Bushë,fshati Gurëshpatë
2. Procedurat e mëtejshme ligjore do të ndiqen nga Drejtoria e Mirëmbatjes së rrugëve Rurale dhe nga Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave të bashkisë Librazhd .
3. Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË  
Mariglen DISHA

Adresa : Sheshi “Gjorg Golemi” Librazhd                          www.bashkialibrazhd.gov.al                  email: info@bashkialibrazhd.gov.al



18 pollyjku e  
①



REPUBLICA E SHQIPERISE  
BASHKIA LIBRAZHD

P/VENDIM

NR \_\_\_\_ DATE \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2023

**"MBI MIRATIMIN E INVESTIMEVE PRIORITARE PER PERIUDHEN 2024-2026"**

Në mbështetje te Ligjit 139/201, date 17.12.2015 "Për Vetqeverisjen Vendore", nen 54 pika dh, te ligjit 68/2017 "Për Financat e Vetqeverisjes Vendore", te Ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërise", i ndryshuar, Udhëzimit Nr.8 datë 29.08.2012 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afat mesëm", si dhe ne udhezimin Nr. 6, dt 28.02.2023 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm Vendore 2024-2026, "Keshilli i Bashkise i mbledhur sot më datë \_\_\_\_ /07/2023 me propozim te Kryetarit te Bashkisë Librazhd

VENDOSI:

1. Te miratojë investimet prioritare ne infrastrukturën e Bashkisë Librazhd , për periudhen 2024-2026 sipas listës bashkelidhur këtij projekt/vendimi.
2. Peër zbatimin e ketij vendimi ngarkohet, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit , Sektori Juridik si dhe Njesitë Organizative.
3. Ky vendim hyn ne fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I BASHKISE

MARIGLEN DISHA



**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA LIBRAZHD**

**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT,  
PROJEKTEVE DHE SHERBIMEVE**

**Lista e Investimeve Prioritare ne infrastrukturen e bashkise Librazhd**

Nr.	Emertimi i Objektit	Vlera
1	Mbikqyrje Kolaudime	10,000,000
2	Studime Projekteve	5,000,000
3	Bashkefinancime me Ministrite e Linjes	30,000,000
4	Reabilitimi i fasadave te bllokut te banimit Nr 1, Bashkia Librazhd	74,156,466
5	Rikonstruksion i cerdhes se qytetit	34,731, 327
6	Sistemim asfaltim i ruges se Fshatit Librazhd-Katund	239,865,847
7	Restaurim i Ures së Vjetër te Librazhdit	25,000,000
8	Ura Togez dhe Rruget Lidhese	69,154,483
9	Rikonstruksion i Muzeut Etnografik	20,275,838
11	Ndertim ujesjellesi per fshatin Zdravja	100,000,000
12	Ndertim ujesjellesi ne fshatin Dragostunje	92, 053, 619
13	Ndertim Ujesjellsit ne fshatin Vehcan	82,289,192
14	Ndertim Ujesjellsit ne fshatin Funares Nj.Orenje	30,000,000
15	Rikualifikim urban Blloku banimit nr. 3 (Lagje Stacioni I Trenit), qyteti Librazhd	210,494,443
16	Riparim lere betoni ne fshatrat Sebisht, Fushe Studen, Polis Gostime, Babje	3.000.000
17	Rikonstruksion i rrugeve rurale dhe veprave te artit te	5,000,000

	Bashkise Librazhd	
18	Sistemim asfaltim rruga Orenje (Vazhdimi) Lot III	400,000,000
19	Asfaltim I rruges Funares –Zdrajsh, Loti III Njesia Adm Orenje	178,390 220
20	Asfaltim I rruges se fshatit Arrez, Njesia adm Qender	100,619,377
21	Sistemim asfaltim rruga Vehcan	190,000,000
22	Rikonstruksion i rruges Polis-Qender Gurshpate, Loti II	182,438,407
23	Sistemim asfaltim rruga Xhyre Qender- Xhyre Mal	188,295,413
24	Sistemim asfaltim rruga Merqize	81,500,000
25	Rikualifikime urbane te qendrave te fshatrave te Bashkise Librazhd	20,000,000
26	Rikonstruksion Ujesjellesi Gurra e Bardhe – Lagje Cekrezit Hotolisht dhe Ujesjellesi Prevalle Lunik	6,213,000
27	Rehabilitim urban dhe mjedisor i perroit te Shese	240,000,000
28	Hapje degezimi kthesa e Geges lagjia Xhami	50,00,000
29	Rikonstruksion ujesjellesi, fshati Vulcan, lagjia Staravec	80,000,000
30	Rikualifikimi i qendrave te fshatrave per te gjithe njesine Hotolisht	100,000,000
31	Rikonstruksion te segmentit rrugore te lagjes Dod-Kove Rrapi- shpia e Karajt	50,000,000
32	Rikonstruksion i ujesjellesit te lagjes Albrahimi	65,000,000
33	Ndertimi i ujembledhesit te lagjes Derven	25.000.000
34	Asfaltimi I segmentit rrugore fshati Lunik – fshati Prevalle	90,500,000
35	Rikonstruksion te segmentit rrugore lagjia Isenaj , lagja Shpata	50.000.000
36	Rikonstruksion te segmentit rrugore qe lidh lagjen Troshku me fshatin Zgosht	99,000,000
37	Rikonstruksion i segmentit rrugor (Botore –Shpatadoll – Llanga ) fshati Letem	99,000,000

	Rikonstruksion i rruges fshati Vulcan	99,705,270
38	Asfaltim i segmentit rrugor Zgosht – fshati Letem	92,500,000
39	Rikonstruksioni i rruges fshati Prevalle-fshati Kostenje	200,000.000
40	Sistemim me asfaltim i rrugeve te brendshme te bashkise Librazhd ne lagjen Sheh dhe Rruga Shebeniku	50,000,000
41	Ndertim rrjeti KUZ lagjia Kokreve	10,000,000
42	Ndertim impiant pastrimi i KUB	81,500,000
43	Sistemim KUZ lagja Kthesa e Babjes	5,200,000
44	Rikonstruksion I kanalit vadites te Allanit Gizvesh Dorez	60,000,000
45	Rikonstruksion i Kanalit Vadites Te Mesit, Gizavesh – Dorez	99,692,106
46	Furnizim me uje i liqenit Fushe Studen	80,000,000
47	Mbrojtja Lumore e Zones Perendimore te qyetit FAZA III	91.000.000
48	Riparime te pjeseshme ne kanalet vaditese ne bashkine Librazhd	4,200,000
49	Blerje tuba per kanalet vaditese	3,000,000
50	Rikonstruksion kanali i Malit Hotolisht ( faza II )	6 ,000, 000
52	Rikonstruksion kanali "Allanit" Dorez, ( Faza I: hyrja + Skeja e ne vazhdim )	15, 000 ,000
53	Rikonstruksion kanali "Allanit" Dorez, ( Faza II: Deri te Skeja )	21, 000, 000
54	Rikonstruksion i kanalit Gurakuq - Orenje, poshte ( Hyrja deri te sifoni i madh )	8, 197, 530
55	Rikonstruksion i kanalit Gurakuq - Orenje, lart ( Orenje deri taksim )	10, 300 ,000
56	Rikonstruksion i kanalit Gostime - Mirake	10 ,000, 000
57	Rikonstruksion kanali Kuturmanit ( Kujtila - Kamolli )	5 ,000 ,000
58	Rikonstruksion kanali rezervuarit Vehcan ( pjesa e fundit )	5, 000 ,000

59	Rikonstruksion kanali Merqize	8,000,000
60	Rikonstruksion kanali "zalli Kokolit"	6,000 ,000
61	Riparim prita lumore Mirake - Plane	1,000,000
62	Riparim perroi i Skodit	1 ,000 ,000
63	Riparime te pjeseshme ne kanale	13,000 ,000
64	Blerje tuba e plasmas per kanalet ujites	7,200,000
65	Permiresimi I kushteve te banimit per komunitete te varfera dhe te pafavorizuara	70,000,000
66	Rikonstruksion i ambulances se fshatit Prevalle	5.000.000
67	Rikonstruksioni i ambulances se fshatit Kostenje	5.000.000
68	Hidroizolimi I shkollave dhe institucioneve	10,000,000
69	Ndertim i shkolles 9-vjecare Funares dhe terrenit sportiv	100,000,000
70	Rikonstruksion I objektit te PMNZSH (Zjarrfiksja) Librazhd	4 ,800,000
71	Rikonstruksion dhe ngritje kati Shkolla 9-vjecare Togez dhe ndertimi i terreneve sportive	45,000,000
72	Rrethim i shkolles 9- vjecare ne fshatin Lunik + tarraca	40,000,000
73	Sistemimi i terrenit sportive te shkolles 9-vjecare Xhyre	45,000,000
74	Asfaltim i rruges "Maksut Kenga" dhe rruges se "Mojsjes" ne qytetin Librazhd	21,466,613
75	Rikonstruksion/ Ndertim i shkolles se mesme "Shefqet Dosku" dhe ndertimi i palestres Dorez	33,512,141
76	Rikonstruksiom i tualetit publik prane Parkut te Qershive	100,000
77	Blerje paisje elektronike	1,200,000
78	Rikonstruksion i ures se Kamares	15.000.000
79	Rikonstruksion i rruges te kasha e qytetit Shejnaze Juka	8,160,052

Konceptoi: J.Balla   
Konfirmoi: B.Bicaku



KRYETARI BASHKISE  
MARIGLEN DISHA



---

**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA LIBRAZHD**

**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT,  
PROJEKTEVE DHE SHERBIMEVE**

**RELACION**

**MBI LISTEN E PROJEKTEVE PRIORITARE NE INFRASTRUKTUREN E BASHKISE  
LIBRAZHD**

Ne kuader te permiresimit te infrastruktures rrugore rurale te Bashkise Librazhd,zhvillimit urban, kerkesat e banoreve dhe kerkesat e administratoreve te njesive administrative jane evidentuar objektet per investime prioritare si me poshte:

***Reabilitimi I fasadave te bllokut te banimit Nr 1, Bashkia Librazhd***

Ky investim prioritar ka të bëjë me rregullimin e fasadave te bllokut të banimit nr.1 Pallatet Jane akualisht m suva te rene dhe te parikonstruktuar. Jane 16 pallate qe perfshin projekti.

Qellimi i projektit eshte jo vetem lyerje dhe suvatim por edhe krijimi i nje uniformiteti i ketij blloku banimi.

***Sistemim asfaltim rruga Librazhd – Katund***

Kjo rruge i sherben ne menyre direkte banoreve te ketij fshati. Eshte rruge kryesore qe lidh rrugen e qytetit te Librazhd me ate te fshatit . Pjesa e rrugës Librazhd - Katund është relativisht në gjendje mjaft të keqe ka nevojë për ndërhyrje të plotë. Rruga eshte e pa asfaltuar , e shtruar me kalldrëm ose rrugë dheri.Rruga lidh disa fshatra me njeri-tjetrin. Zhvillimi ne keto fshatra eshte penguar nga mungesa e infrastruktures. Fshatrat Librazhd-Qender, Librazhd –Katund, Lagjia Lugjet e Hyses jane fshatra qe lidhen me te njetin segment rrugor , rruge e cila eshte e parikonstruktuar. Asfaltimi i rruges qe lidh keto fshatra eshte domosdoshmeri edhe per faktin e zhvillimit turistik te zones por edhe per lethesimin e jetes se banoreve. Ne keto fshatra banojne rreth 1500 banore. Bashkia Librazhd ne mungese fondesh e ka patur te pamundur asfaltimin e rruges Librazhd-Qender- Librazhd- Katund- Qarrishte.

***Rikonstruksion i Muzeut Etnografik***

Muzeu etnografik I qytetit te Librazhdit shenjon gjurme te histories dhe trashegimise se qytetit te Librazhdit dhe krahinave perreth. Qe nga ndertimi ne kete objekt kane munguar investimet. Godinat e muzeve, të cilat shpalosin trashëgiminë tonë historike e kulturore janë ndërtesa me karakter përfaqësues dhe shumë të veçantë. Ato ekspozojnë dhe njëkohësisht shërbejnë si një

mbështjellje mbrojtëse ndaj kushteve të jashtme klimatike të objekteve të rëndësishme dhe në disa raste unike të trashëgimisë tone.

### ***Ndertim Ura e Varur Togez***

E ndërtuar më shumë se 40 vjet më parë, ura e varur që lidh fshatin Togës me pjesën tjetër të Librazhdit është shumë e dëmtuar. Ura, me gjatësi rrëth 90 ml, është e pakalueshme dhe e rezikshme pasi është dëmtuar nga reshjet e shumta dhe erozioni. Ura Togës iu shërben rrëth 500 banorëve dhe është mundësia e vetme kalimi për në rrugën automobilistike për të gjithë banorët e zonës, të cilët sot nuk arrinë të lidhen me pjesën tjetër të bashkisë dhe të marrin shërbimet të nevojshme për jetën e përditshme.

### ***Rikonstruksion i Urës së vjetër, Librazhd***

Objekti ndodhet në pjesën hyrëse të qytetit të Librazhdit. Ura e Vjeter daton në vitin 47, ka një gjatësi totale 110 m me gjerësi 5.5 m, me trotuare anësore 1.1 m.

Ura është konstruksion tipik urë trarësh, me një korsi për automjete dhe trotuare anësore për këmbësoret. Struktura e shpatullave të ures janë me kollona beton arme dhe tuba hekuri  $\phi 42$ , pjesërisht me mure betoni. Qellimi i nderhyrjes ne ure konsiston ne rikonstruksion i gjendjes ekzistuese te saj, ridizenjim i elementeve te infrastrukturese se vjeter, hapesire rekreative per forcimin e identitetit kulturor te qytetit, atraksion turistik. Materiali i perdonur si elemet kryesor per rikonstruksion do jete grui i zallit te lumi Shkumbin, karakteristike e zones.

### ***Asfaltim i rruges Funares –Zdrajsh, Loti III Njesia Adm Orenje***

Ky segment rrugor fillon nga fshati Funarës dhe vazhdon deri në qendrën e fshatit Zdranjsh. Infrastruktura rrugore ekzistuese në këtë segment është në gjendje të amortizuar për shkak të viteve dhe mirëmbajtjes së ulët. E gjithë gjatësia e rrugës është me zhavor por faktorët atmosferikë kanë sjellë deformimin e trupit të rrugës.

### ***Ndertim Ujesjellesi ne fshatin Vehcan***

Bashkia Librazhd ,ne kuader te permiresimit te furnizimit me uje te pijshem te banoreve te zonave rurale, nen administrim te saj , ka hartuar projektin “Ndertim Ujesjellesi ne fshatin Vehcan” .Nepermjet ketij projekti do te sigurohet furnizimi me uje te pijshem i rrëth 1200 banoreve aktuale te fshatit Vehcan. Eshte investim prioritar.

### ***Ndërtim ujësjelleesi në fshatin Dragostunjë***

Në kuadër të përmirësimit të furnizimit me ujë të pijshëm të banorëve të zonave rurale bashkia Librazhd ka hartuar projektin “Ndërtim ujësjelleesi në fshatin Dragostunjë”, i cili ngafq ky projekt do te furnizohen me ujë të pijshëm rrëth 2100 banorë. Aktualisht fshati furnizohet me puse me thellësi deri në 25m. Kjo zonë është në zhvillim e sipër dhe detyra e projektimit është dhënë për një prespektivë 20- vjeçare.

### ***Ndërtimi Ujësjelleesi në fshatin Funarës, njësia administrative Orenjë***

Eshtë një ndër investimet prioritare të Bashkisë Librazhd dhe në kuadër të përmirësimit të furnizimit me ujë të pijshëm të banorëve të zonave rurale është menduar ndërtimi i një ujësjellësi që do të sigurojë furnizim me ujë të pijshëm për rrith 1500 banorë të këtij fshati.

#### ***Rehabilitimi urban blloku banimit nr.3 (Lagje Stacioni i Trenit) Bashkia Librazhd***

Ky investim prioritar ka te beje me sistemimin e rrugeve te pashtuara, fasadat e pallateve rehabilitimin e shesheve te pushimit si dhe sistemimi i ujerave te bardha (KUB) si dhe sistemimi i ujerave te ndotura (KUZ).

#### ***Ndertimi i shkolles 9- vjecare Funares dhe terrenit sportiv***

Ndertimi i shkolles eshte rast emergjente pasi shkolla aktuale “9 vjecare” ne fshatin Funares u shpall e pa riparueshme pas demeve nga termetit. Nga ky investim rrith 125 nxenes dhe mesues qe mesojne ne kete shkolle jane perfitues direkt te ketij investimi dhe mbi 1500 banore te fshatit Funares e Neshte .

#### ***Sistemim asfaltim rruga Vehcan***

Bashkia Librazhd ne kuader te permirsimit te infrastruktures ka menduar qe ne listen prioritare te jete edhe sistemimi i rruges Vehcan. Kjo rruga konsistohet rruge rurale me shtresa rrugore qe perbehen vetem nga formacione te dherave te zones, dhe ne disa segmente edhe shtresa me kalldrem, pa sisteme te largimit te ujrave te shiut. Rruga eshte e ngushte me gjeresi deri ne 3 m. Ky segment rrugor kalon neper një terren te thyer malor.

#### ***Sistemim asfaltim rruga Xhyre Qender- Xhyre Mal***

Xhyra eshte fshat i bashkise Librazhd, i njesise administrative Hotolisht, me një distance rrith qytetit te Librazhdit afro 10 km. Fshati shtrihet per gjate lumit Shkumbin, ku vijon shtrihet ne majat e shkembijve perreth. Ne te kater stinet e vitit fshati Xhyres ofron bukuri natyrore. Zona e Xhyrës është nga ata zona që nuk është studiuar në thellësi për të njohur historinë që fshihet në këto male, por fakti që në këtë zonë gjenden gjurmë të rrugës së vjetër Egnatia e që Gjorg Golemi luftontë në këto anë në mbështetje të Skënderbeut tregon që kjo zonë ka një histori të vjetër e të pasur. Vendosja në mes të Gegërisë e Toskërisë dhe me një komunitet Gollobordas në veri të saj e bëjnë këtë kulturë të larmishme në dialekta, në veshje të ndryshme popullore e tradita. Banorët vendas si dhe emigrantë të kthyer i kanë dhënë kuptim dhe hijeshi jetës atje. Shtëpitë e rindërtuara dhe kthimi i tyre në bujtina pritëse për turistët, është burimi kryesor i të ardhurave ekonomike. Zona e fshatit te Xhyres njihet per bujqesine dhe blektorine e zhvilluar. Ne fshat jane hapur bujtina ku ofrojne ushqime tradicionale por jo vetem pasi duke u shtrire per gjate rrjedhes se lumit Shkumbin nuk mungon peshku. Historiku i Fshatit Xhyre identifikohet me “Kalane e Xhyres” dhe segmentin e rruges “Egnatia”. Rruga e asfaltuar eshte ne gjatesine 2 km deri ne qender te fshatit Xhyre. Segmenti I rruges se parikonstruktuar eshte ne gjatesine 3 km.

Kjo rruga i sherben ne menyre direkte banoreve te ketij fshati, jane rruge dytesore dhe segmente qe aktualisht ne terren jane ne kushte fizike jo te mira. Sherbejne si rruge kalimi per automjetet. Veshtiresi paraqitet ne keto segmente kryesisht gjate muajve te dimrit ku keto akse jane kthesa te forta dhe pa bazament te qendueshem.

### **Rikonstruksion I objektit te PMNZSH(Zjarrfiksja) Librazhd**

Objekti është egzistues por nga dëmtimi që ka pësuar si pasojë e lagështirës së krijuar nga mungesa e hidroizolimit, ky objekt nuk ka kushte të përshtatëshme për tu perdonur, prandaj është menduar rikonstruksioni i plotë i tij.

### **Asfaltim I rrugës së fshatit Mërqizë, Njësia adm Qendër**

Ky segment rrugor fillon nga rruga nacionale Elbasan-Librazhd deri në qendrën e fshatit. E gjithë gjatësia është e mbuluar me zhavor dhe kushtet atmosferike kanë bërë që trupi i rrugës të deformohet. Gjatësia e këtij projekti është 1428 ml dhe perfittues për këtë projekt janë 800 banorë. Është investim prioritar.

### **Asfaltim I rrugës së fshatit Arrëz, Njësia adm Qendër**

Ky segment fillon nga rruga nacionale Elbasan- Librazhd- Prrenjas dhe vazhdon deri në qendrën e fshatit. Infrastruktura rrugore ekzistuese në këtë segment është e amortizuar për shkak të viteve dhe mirëmbajtjes së ulët. Kushtet atmosferike kanë bërë qe trupi i rrugës të pësojë ndryshime duke devjuar. Është investim prioritar.

### **Rikonstruksion i çerdhes së qytetit**

Çerdhja Nr. 1 ndodhet në territorin e Bashkisë Librazhd, në afërsi të qendrës së qytetit. Godina është e përbërë në 2 kate. Parashikohet zgjerimi I ambineteve te fjetjes dhe shtimi I shtreteve ne te 4 sektoret. Dyshemeja është e shtruar me pllaka majolike të cilat janë të dëmtura dhe të vjetërura të cilat shkatojnë papastërti në ambjetet e brendshme dhe vështirësi për tu pastruar. Suvaja ekzistuese është me llac-gëlqere, pjesa e brezit të poshtëm në të gjithë perimetrin e godinës është e dëmtuar si brenda edhe jashtë godinës. Sipasoje e dëmtimeve në strukturën e suvasë në godinë ka edhe prani të ujit nëmure gjë e cila sjell edhe lagështi në objekt dhe krijimin e mykut.

### **Rikonstruksion I kanalit vaditës të Allanit Gizvesh Dorëz**

Kanali I Allanit me një gjatësi prej 11106 m dhe mbulon me vaditje fshatin Gizavesh, Dorëz dhe Librazhd-Qendër. Gjendja fizike aktuale e kanalit është shumë e amortizuar dhe vende vende e dëmtuar si pasojë e rrëshqitjeve dhe dëmevë të ndryshme të faktorëve atmosferikë.

### **Rikonstruksion i kanalit vadites te Mesit, Gizavesh-Dorez**

Qellimi i objektit eshte permiresim i sistemit vadites te fshatrave Gizavesh, Dorez, Librazhd-Qender. Gjendja ekzistuese e kanalit vadites eshte e amortizuar edhe pse ka nderhyrje nga bashkia, kanali ka ndërhyrje te pjesshme dhe rezultati që ato mkanë dhënë ka qënë jo afatgjatë. Prandaj sifoni i ndërtuar vitet e fundit nga bashkia ka nevojë për riparime.

### **Sistemim me asfaltim i rrugeve te brendshme te bashkise Librazhd ne lagjen Sheh dhe Rruga Shebeniku**

Kjo rrugë është rrugë kryesore e qytetit. Pjesa e rrugës Sheja dhe Shebenik është relativisht në gjendje mjaft të keqe ka nevojë për nderhyrje të plotë. Rruga është e pa asfaltuar , të shtruara me

kalldrëm ose rrugë dheu, Jane afersisht 20 familje qe kane akses ne ket rruge dhe hasin problem me kalimin e mjeteve.

#### ***Rikonstruksion dhe ngritje kati Shkolla 9-vjecare Togez dhe ndertimi i terreneve sportive***

Nga ky investim rreth 125 nxenes dhe mesues qe mesojne ne kete shkolle jane perfitues direkt te ketij investimi dhe mbi 500 banore te fshatit Togëz .Qellimi kryesor i projektit eshte qe nxenesit te ndihen sa me rehat ne ambientet e shkollës si brenda por edhe jashte.

#### ***Riparim Lere betoni ne fshatrat Sebisht, Fushe Studen, Polis Gostime, Babje***

Terreni i veshtire ne rruge kryesore te fshatrave kane kthesa te forta dhe segmente qe nevojitet zbutje me lere betoni per te mos hasur pengesa automjetet qe kalojne ne keto akse.

Shpesh keto segmente jane bere burim aksidentesh.

#### ***Rikonstruksion i rrugeve Rurale dhe Veprave te Artit te Bashkise Librazhd***

Qellimi i ketij projekti eshte rehabilitimi i segmenteve rrugore te rrezikshme ne fshatrat e bashkise Librazhd nepermjet veprave te artit dhe ndertimit te shtresave rrugore te qendrueshme pasi gjate dimrit kushtet atmosferike çojne ne amortizimin e disa prej segmenteve rrugore.

#### ***Sistemim Asfaltim Rruga Polis-Qender, Polis –Gurshpate Faza II***

Ne vijim te investimit te realizuar shtrim me asfalt ne gjatesi 3 km te rruges Polis, vazhdon te jete problematike mungesa e shtrimit te rruges ne vazhdimin e rruges. Banoret qe perfitojne nga kjo rruga jane rreth 1500. Aktualisht segmenti i rruges eshte i amortizuar dhe ka nevoje per nderhyrje.

#### ***Rikualifikim urbane te qendrave te fshatrave te Bashkise Librazhd***

Ne kuader te rikualifikimit te qendrave te fshatrave lind nevoja per rehabilitimin e sheshevë dhe rrugeve te lagjeve ne qender te fshatrave . Realizimi i ketij investimi lehtson funksionimin e tregjeve ne zona te caktuara por edhe rritjen e vizitoreve .

#### ***Blerje tuba per kanalet Vadite***

Sistemi vadites duke qene faktor kyc ne bujqesi , lind nevoja per investim te herepashershem dhe mirebajtje te objekteve si kanalet vadite se etj.

#### ***Rehabilitim urban dhe mjedisor i përroit të Shesë***

Rehabilitimi i përroit të Shesë është një projekt madhor pasi shërben përmbrötjjen nga përmbytjet të objekteve shtëpi banimi, njësi shërbimi të ndryshme dhe mbrotjen e rrugës automobilisike Librazhd- Korçë.Ky investim i sherben banoreve te qytetit.

#### ***Rikonstruksion ujësjellësi, fshati Vulcan, lagjia Staravec***

Eshtë një ndër investimet prioritare të Bashkisë Librazhd dhe në kuadër të përmirësimit të furnizimit me ujë të pijshëm të banorëve të zonave rurale është menduar ndërtimi i një ujësjellësi

që do të sigurojë furnizim me ujë të pijshëm për rreth 700 banorë të këtij fshati. Burimin e ujit ky projekt e ka nga Gura Bukur.

#### ***Rikonstruksion i rruges fshati Vulcan***

Kjo rrugë është me rëndësi të madhe për lëvizjen e brendshme të banorëve të fshatit Vulçan. Gjendja e këtij segmenti rrugor është teje i amortizuar. Ky segment nuk është trajtuar asnjëherë për mirëmbajtje dhe e gjithe gjatësia është e patrajtuar. Drenazhimi i ujërave të shiut është jo funksional. Gjatesia e rrugës është 2900 ml dhe nga ky projekt përfitojne 1200 banorë.

#### ***Asfaltim i segmentit rrugor Zgosht – fshati Letem***

Ky segment rrugor fillon nga fshati Zgosht dhe vazhdon deri në qendrën e fshatit Letëm. Ky segment eshte tejet i amortizuar dhe i demtuar gjate gjithe gjatesise se tij. Jane rreth 100 familje qe banojne ne keto zone.

#### ***Rikualifikimi i qendrave te fshatrave per te gjithe njesine Hotolisht***

Ne kuader te rikualifikimit te qendrave te fshatrave lind nevoja per rehabilitimin e shesheve dhe rrugeve te lagjeve ne qender te fshatrave . Realizimi i ketij investimi lehteson funksionimin e tregjeve ne zona te caktuara por edhe rritjen e vizitoreve .

#### ***Mbrojtja lumore e zones perendimore te qytetit Faza III***

Ky segment eshte vazhdimi i Lotit II. Projekti konsiston kryesisht ne krijimin e nje hapesire rekreative per banoret e qytetit duke sheérbyer si shetitore per gjate bregut te Lumin Shkumbin, por njekohesisht edhe si mbrojtje nga permbytjet qe mund te shkaktohen nga lumi here pas here per zonat perreth. Gjatesia totale e projektit eshte 650 ml.

Konceptoi: J.Balla  
Konfirmoi: B.Bicaku



KRYETARI BASHKISE  
MARIGLENDISHA

